



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:168685

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06653645

C.nr.233/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarën Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. K. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS. L.L.C” nga Prishtina, Blv. D. e K. Ul. C..., 2/.. hyrja 1., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komuna e Arsimit me seli në Dragash, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit përfaqësuesi Isljam Rexheplar nga Dragashi, me objekt kontesti Kompensimin e avancimit të karrier - Licencat, vlera e kontestit 888.03 Euro, jashtë seance me datën 26.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. K. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS. L.L.C” nga Prishtina, Blv. “D. e K.” Ul. C-2, 2/.. hyrja 1., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Isljam Rexheplar nga Dragashi, lidhur me kompensimin e avancimit në karrier dhe zhvillim profesional, me të cilën ka kërkuar që të: “Detyrohet e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash që paditësit në emër të avancimit në karrier dhe zhvillim profesional të ia paguaj kompensimin prej 10% të një page bazë që nga data 18.04.2017 – 27.03.2018 me kamat ligjore prej 8% nga dita e shkaktimit të dëmit gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, e krejt këto në afat prej 7 ditësh nga plotëfuqishmëria e aktgjyqimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Nga ana e paditësit Sh. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim i përfaqëson Shoqeria e Avokatëve: Studio Ligjore&Financiare “K. Ass.” me avokatët e saj në Prishtinë, është paraqitur padia kundër të paditurës Komuna e Dragashit – DKA-së në Dragash, për shkak të kompensimit të Inflacionit, ku ka theksuar se e drejta materiale e paditësit konsiston në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar me datë 18.04.2017, ku paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe të njëjtit i takon kompensimi mbi bazën e inflacionit edhe atë për periudhën 18.04.2017 – 27.03.2018 kur edhe paditësi është pensionuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se në bazë të dokumentacionit, e drejta e padisë është vjetërsuar në tërësi nga

arsyeja që nga data e daljes në pension 27.03.2018 (sipas vertetimit SHFMU “U.” nr.09/2022) deri në paraqitjen e padisë, kishin kaluar më shumë se 3 vjet. Të gjitha obligimet janë parashkruar. Nga këto fakte dhe rrethana të prezentuara më lartë, kërkojmë nga gjykata ta refuzoj padinë sit ë pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Ndërkaq gjykata duke shqyrtuar padinë e paditësit sipas detyrës zyrtare por edhe sipas kundërshtimeve të palës së paditur nga përgjigjia në padi dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ka vlerësuar se padia e paditësit është e vjetërsuar, po citojmë: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënja e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se nga kopja e leternjoftimit për paditësin provohet se i njëjti ka lindur me datë 27.03.1.... e që nënkupton se i njëjti me datë 27.03.20... i ka mbushur edhe vitet e pensionimit e që nënkupton se edhe automatikishtë i është ndërprerë marrëdhënja e punës. Kurse kërkesa respektivishtë padia i është dorëzuar gjykatës me datë 17.08.2022 e që nënkupton një (1) vit e pesë (5) muaj pas kalimit të afatit prej 3 vitësh ashtu edhe siç është specifikuar me dispozitën e cituar më lartë.

Gjithashtu në bazë të nenit 399 par. 1 të LPK-së është parashikuar: *“Kur gjykata, pasi që t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Ndërsa me Ligjin e Punës neni 87 i tij në mënyrë taksative është përcaktuar afati prej tre (3) vitësh si afat për parashkrimin e kërkesave nga marrëdhënja e punës në para, e nga padia konstatohet se kjo kërkesë është kërkesë rreth pagesës monetare në lidhje me kualifikimin – licencimin dhe se e njëjta është parashtruar në gjykatës pas afatit të parashikuar me dispozita materiale respektivishtë Ligjin e punës, kurse pala e paditur është thirur në vjetërsim ndërsa fakti i tillë nuk është kontestues mes palëve kontestuese.

Gjykata vendosi që secila palë t’i kompenson shpenzimet e veta, pasi palës paditëse i është refuzuar padia, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar kërkesë të specifikuar për njohjen e tyre. Përndryshe, vendimarrja në lidhje me këtë pikë bazohet në nenin 463 paragrafin 2 të LPK-së.

Andaj gjykata duke marrë parasysh argumentet e paraqitura më lartë, ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 399 parag. 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:168685, 26.12.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.